


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.02.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-4237/13, për z. Fahredin Veselaj – U.d. Drejtor në Klinikën e Urologjisë - QKUK, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-4237/13, për zyrtarin e lartë z. Fahredin Veselaj – U.d. Drejtor në Klinikën e Urologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “VITA HOSPITAL” SH.P.K. dhe pronar në “O.S.U. UROMED”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Veselaj, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj, për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushtron funksionin e U.d. Drejtorit në Klinikën e Urologjisë në QKUK

dhe njëkohësisht është person i autorizuar në biznesin privat "VITA HOSPITAL" SH.P.K. dhe pronar në "O.S.U. UROMED".

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të autorizoj një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin privat "UROMED", ndërsa për biznesin "VITA HOSPITAL" do të heqë dorë nga pozita e personit të autorizuar, ashtu siç parashihet me ligj.

Ndërkohë, z. Veselaj, ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 575/14 dhe DPKI 03 – 575/14) në të cilat vërtetohet se i njëjti ka bërë ndryshimet e premtuara.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

